
FIRST AND SECOND LANGUAGE LEARNING THROUGH TEXTBOOKS IN ALBANIAN SCHOOLS (COMPARATIVE OVERVIEW OF ALBANIAN AND ENGLISH LANGUAGE TEXTBOOKS)

Rina Muka

University “Luigj Gurakuqi”, Faculty of Educational Sciences, Albania, gerarina@yahoo.com

Irida Hoti

University “Luigj Gurakuqi”, Faculty of Social Sciences, Albania, iridahoti2000@yahoo.com

Abstract: The language acquired from the childhood is the language spoken in the family and in the place of living. This language is different from one pupil to another, because of their social, economical conditions. By starting the school the pupil faces first the ABC book and then in the second grade Albanian language learning through the Albanian language textbook. By learning Albanian language step by step focused on Reading, Writing, Speaking and Grammar the pupil is able to start learning the second language on the next years of schooling. So, the second language learning in Albanian schools is related to the first language learning (mother tongue), since the early years in primary school. In our schools, the second language (English, Italian) starts in the third grade of the elementary class. On the third grade isn't taught grammar but the pupil is directed toward the correct usage of the language. The textbooks are structured in developing the pupil's critical thinking. The textbooks are fully illustrated and with attractive and educative lessons adequate to the age of the pupils. This comparative study will reflect some important aspects of language learning in Albanian schools (focused on Albanian language - first language and English language - second language), grade 3-6. Our point of view in this paper will show not only the diversity of the themes, the lines and the sub-lines but also the level of language knowledge acquired at each level of education. First, the study will focus on some important issues in comparing Albanian and English language texts as well as those which make them different: chronology and topics retaken from one level of education to another, so by conception of linear and chronological order will be shown comparatively two learned languages (mother tongue and second language). By knowing and learning well mother tongue will be easier for the pupil the foreign language learning. The foreign language (as a learning curriculum) aims to provide students with the skills of using foreign language written and spoken to enable the literature to recognize the achievements of advanced world science and technology that are in the interest of developing our technique. Secondly, the study will be based on the extent of grammatical knowledge, their integration with 'Listening, Reading, Speaking and Writing' as well as the inclusion of language games and their role in language learning. The first and second language learning in Albanian schools (grade III-VI) is based on similar principles for the linearity and chronology of grammatical knowledge integrated with listening, reading, writing and speaking. The different structure of both books help the pupils integrate and use correctly both languages. In the end of the sixth grade, the pupils have good knowledge of mother tongue and the second language and are able to write and speak well both languages.

Keywords: first and second language learning, language textbooks, listening, reading, speaking, writing.

**MËSIMI I GJUHËS SË PARË DHE TË DYTË NË SHKOLLAT SHQIPTARE
(Vështrim krahasues i teksteve gjuhë shqipe - gjuhë angleze)****Rina Muka**

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, gerarina@yahoo.com

Irida Hoti

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, iridahoti2000@yahoo.com

Abstrakt: Gjuha e fituar nga fëmijëria është gjuha që flitet në familje dhe gjuha e vendit ku jeton. Kjo gjuhë ndryshon nga një nxënës tek tjetri për shkak të kushteve sociale, ekonomike të rritjes së tyre. Duke filluar shkollën nxënësi përballet së pari me librin e Abetares dhe më pas në klasën e dytë me mësimin e gjuhës shqipe përmes tekstit të gjuhës shqipe. Duke mësuar gjuhën shqipe hap pas hapi përmes të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe gramatikës, nxënësi është i aftë të fillojë mësimin e gjuhës së dytë në vitet e ardhshme të shkollimit. Kështu mësimi i gjuhës së dytë në shkollat shqiptare lidhet me mësimin e gjuhës së parë (gjuha amtare). Në shkollat tona, gjuha e

dytë (anglisht, italisht) fillon në klasën e tretë të arsimit fillor. Në klasën e tretë nuk mësohet gramatikë, por nxënësi drejtohet drejt përdorimit të saktë të gjuhës. Tekstet janë plot ilustrime dhe me tekste tërheqëse dhe edukative për moshën e nxënësve. Ky studim krahasues do të pasqyrojë disa aspekte të rëndësishme të mësimin të gjuhës në shkollat shqiptare (të përqendruara në gjuhën shqipe - gjuha e parë dhe gjuha angleze - gjuha e dytë), klasat 3-6. Këndvështrimi ynë në këtë punim do të tregojë jo vetëm larminë e temave, linjave dhe nënlinjave, por edhe nivelin e njohurive gjuhësore të fituara në çdo nivel shkollimi. Së pari, studimi do të përqendrohet në disa çështje të rëndësishme në krahasimin e teksteve të gjuhës shqipe dhe angleze, si dhe ato që i bëjnë ato të ndryshme: kronologjia dhe temat e rimarra nga një nivel shkollimi në tjetrin, kështu nga koncepti i rendit linear dhe koncentrik do të tregohen në mënyrë krahasuese dy gjuhët e mësuara (gjuhë amtare dhe gjuhë e dytë). Njohja dhe mësimi mirë i gjuhës amtare do ta bëjë më të lehtë mësimin e gjuhës së dytë. *Gjuha e huaj (si lëndë mësimore)*, ka si qëllim t'i pajisë nxënësit me shprehjet e përdorimit të gjuhës së huaj të shkruar e të folur, për të mundur kështu që nëpërmjet literaturës të njihen arritjet e shkencës e të teknikës së përparuar botërore që janë në interes të zhvillimit e të teknikës sonë. Së dyti, studimi do të bazohet në shkallën e njohurive gramatikore, integrimin e tyre me 'Të dëgjuarit, Leximin, Të folurit dhe Të shkruarit', si dhe përfshirjen e lojërave gjuhësore dhe rolin e tyre në mësimin e gjuhëve. Mësimi i gjuhës së parë dhe të dytë në shkollat shqiptare në klasat III-VI, mbështetet në parime përgjithësisht të njëjta për nga lineariteti dhe kronologjia e njohurive gramatikore të integruara me të dëgjuarin, të lexuarin, të shkruarit dhe të folurit. Strukturat e ndryshme të dy librave ndihmojnë nxënësin të integrojë dhe të përdorin saktë të dy gjuhët. Në fund të klasës së gjashtë nxënësit kanë njohuri të mira të gjuhës amtare dhe gjuhës së dytë dhe janë të aftë të flasin dhe të shkruajnë mirë të dy gjuhët.

Fjalë kyçe: të mësuarit e gjuhës së parë dhe të dytë, tekstet e gjuhës, të dëgjuarit, leximi, të folurit, të shkruarit.

HYRJE

Mësimi i gjuhës amtare, gjuha, të cilën një individ e fiton në fëmijërinë e hershme është gjuha që flitet në familje dhe gjuha e vendit ku ai jeton. Gjuha amtare është gjuha e parë që fëmija fiton, por ka edhe përjashtime. Ky term shpesh përdoret si sinonim i 'gjuhë e parë'. Ai fillon që nga arsimit parashkollor në mënyrë intuitive dhe vazhdon në ciklin fillor që në klasën e dytë. "*Gjuha amtare (si lëndë mësimore)*, një nga disiplinat më të rëndësishme mësimore që jepet në të gjitha klasat e shkollës nëntëvjeçare që ka për qëllim t'i pajisë nxënësit me njohuri e shprehje bazë për zbatimin me aftësi nga ana e tyre të normave letrare leksikore, gramatikore, drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore të gjuhës standarde në të folur dhe në të shkruar, t'i ndihmojë në formimin e përgjithshëm të tyre dhe t'i edukojë me dashuri për gjuhën shqipe. Gjuha shqipe quhet edhe gjuhë amtare. (*Fjalor i gjuhës shqipe*, 1954: 9) *Gjuha e huaj (si lëndë mësimore)*, ka si qëllim t'i pajisë nxënësit me shprehjet e përdorimit të gjuhës së huaj të shkruar e të folur, për të mundur kështu që nëpërmjet literaturës të njihen arritjet e shkencës e të teknikës së përparuar botërore që janë në interes të zhvillimit e të teknikës sonë. (Osmani, 1983: 244)


STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTEVE TË GJUHËS SHQIPE




'*Gjuha shqipe 2*' (Petro, Gjokutaj, 2003) libri i parë i gjuhës, të cilin nxënësit e mësojnë pasi kanë mbaruar Abetaren. Personazhi kryesor, Era i shoqëron fëmijët nga faqja në faqe. Teksti është i ndarë në 6 pjesë: *Era në shtëpi*, *Era jashtë shtëpisë*, *Përrallat e gjyshes*, *Përrallat gjyshit*, *Ëndrrat e Erës dhe Era në internet*. Në katër pjesët e para, rubrika "Lexim" shoqërohet nga rubrikat: *Flasim së bashku*, *Të njohim gjuhën tonë*, *Të shkruajmë*, ndërsa dy pjesët e fundit përfshijnë tema për lexim të shoqëruara me seksionet "*Flasim së bashku*". Temat në rubrikën "*Të shkruajmë*" dhe "*Të flasim*" lidhen direkt me pjesët e leximit. "Leximi" lidhet me nënçështje, si: *Pyetje rreth tekstit*, *Lexoje pjesën në role*, *Punojmë së bashku* etj. Fragmentet e leximit janë të shoqëruara me një fjalor shpjegues rreth fjalëve të reja në tekst. Njohuritë paraqiten në mënyrë lineare dhe integrohen në mënyrën e duhur. Njohuritë gramatikore përfshijnë njohuri nga *sintaksa*, *morfologjia* dhe *drejtshkrimi*, njohuri këto të shoqëruara me rregulla të përshtatshme për moshën e fëmijëve, si edhe të shoqëruara me shembuj e ushtrime aplikuese.



“**Gjuha shqipe 3**” (Petro, Pepivani, 2003) është i ndarë në 7 pjesë: *Unë mësoj nga të rriturit; Unë mësoj nga miqtë e mi; Unë mësoj nga përrallat; Unë mësoj nga tregimet; Unë mësoj nga natyra; Unë mësoj nga lojërat dhe fantazitë dhe Unë mësoj nga internet.* Ky tekst çdo ndarje e ka të zberthyer në 4 rubrika: **Njohuritë gjuhësore**, ku përfshihen: *Ushtrohu, mbaj mend, gjej, dallo, lexo, krijo, lidh, vendos, shkruaj e nënvijëzo.* **Lexim**, ku përfshihen pjesë leximi, *fjalorth lidhur me tekstin, pyetje rreth tekstit, kthehu tek teksti, Po ti?* **Flasim**, ku përfshihen: *luajmë së bashku, diskutojmë, flasim.* **Shkruajmë**, ku përfshihen: *shkruaj, ushtrohu, mëso, shiko figurat.* Teksti ka ilustrime dhe është tërheqës për fëmijët.




“**Gjuhë shqipe 4**” (Petro, Pepivani, 2003) është i ndarë në 4 pjesë: *Çdo ditë së bashku; Mirësi dhe paqe; Lojëra dhe fantazi dhe E shkuara në përralla e tregime.* Ky tekst çdo ndarje e ka të zberthyer në 4 rubrika: **Njohuritë gjuhësore**, ku përfshihen: *Ushtrohu, mbaj mend, gjej, kujto, lexo, Mëso, lidh me shigjeta, vendos, shndërro , përgjigju.* **Lexim**, ku përfshihen pjesë leximi, *fjalorth lidhur me tekstin, kupto tekstin, Mëso më shumë, Po ti?* **Flasim**, *bisedojmë së bashku, diskutojmë, dëgjo.* **Shkruajmë**, *mëso me shkrim, punë në grupe.* Teksti ka ilustrime në të gjitha rubrikat, konceptet kryesore paraqiten në kutiza.




“**Gjuhë Shqipe 5**” (Petro, Pepivani, Çerpja, 2003) është i ndarë në 6 pjesë: *Pasqyra e ditës; Pasqyra e dëshirave; Pasqyra e pyllit; Pasqyra e përrallave; Pasqyra e fantazisë dhe Pasqyra e historisë.* Ky tekst çdo ndarje e ka të zberthyer në 5 rubrika: **Njohuritë gjuhësore**, ku përfshihen: *Ushtrohu, përshkruaj, gjej, shpreh, lexo, krijo, lidh, vendos, shkruaj e zëvendëso.* **Lexim**, ku përfshihen pjesë leximi, *kupto përmbajtjen, nxirr mesazhin, analizo gjuhën/strukturën.* Shoqërohen me informacione për librin nga është marrë pjesa(fragmenti). **Të flasim**, ku përfshihen: *luajmë në grupe, diskutoni, ushtrohu me të dëgjuar, kujto dhe shto njohuritë, këshilla të dobishme.* **Të shkruajmë**, ku përfshihen: *shkruaj, ushtrohu, përshkruaj.* **Drejtshkrim**, ku përfshihen: *ilustrime tek të gjitha rubrikat, konceptet kryesore paraqiten në kutizë.*

STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTEVE TË GJUHËS ANGLEZE



Teksti Welcome 1 është i planifikuar për nxënësit e klasës së tretë të arsimit fillor. Përbëhet nga 9 module. Çdo mësim është i përbërë nga 4 pjesë, ku pjesa IV (Culture Channel) përmbledh informacion kulturor, fakte historike, kuriozitete, personazhe të shquara etj. Pas çdo dy mësimesh ka një përmbledhje ushtrimesh praktike për mësimet paraardhëse. Thuajse në fund të çdo mësimi nxënësit mësojnë edhe një këngë në përshtatje me përmbajtjen e mësimet. Në fund të tekstit ka një fjalor përmbledhës për secilin mësim me fjalët e reja . Në fund të librit të nxënësit ndodhet dhe një certifikatë simbolike që plotësohet në fund të vitit shkollor. Teksti i nxënësit shoqërohet edhe me një fletore pune dhe një CD për ushtrimet dëgjimore. Nxënësit mësojnë si të prezantohen dhe të pyesin të tjerët, njohin objekte të ndryshme shkollore, pjesëtarët e familjes, numrat deri në 20, rasa gjinore (s’), ngjyrat, profesionet, pjesët e trupit e të fytyrës, orën, lëndët shkollore, format, të shkruajnë një letër etj. Pas një grupi mësimesh ka një përshkrim përmbledhës përmes *Portfolio-s* (ide e lidhur me Portofolin European të Gjuhëve).


Mësojnë përdorimin e nyjeve *a/an*; përemrave *this/that; these/those*; foljes *can/can't*; Kërkesat më të hasura në këtë tekst janë: Look & Say; Listen & Repeat; & Write; Underline & Correct; Listen & Read etj. Vihet re se pjesa dëgjimore dhe ajo praktike janë më dominueset në veprimtaritë e nxënësit.



”Welcome 2” është vazhdimi i tekstit “Welcome 1” dhe ruan të njëjtën përmbajtje dhe strukturë me të, por në një shkallë më të lartë të njohurive gramatikore dhe pasurimit leksikor të nxënësit. Nxënësit mësojnë si të prezantohen dhe të pyesin të tjerët, pjesëtarët e familjes, numrat 20 deri në 100, drejtime përmes përdorimit të parafjalëve të vendndodhjes, moti, profesionet, pjesët e trupit e të fytyrës, orën, frutat, kafshët, të tregojë ditën, datën dhe muajin, mbiemrat e kundërt dhe shkallën krahasore e sipërore të tyre etj. Nxënësit mësojnë përdorimin e *a/an*; *some/any*; *can/can't*; *do/does*; *did/didn't* si dhe kohën e shkuar (past tense) të foljeve të çrregullta dhe present continuous tense.


ACCESS 1

Struktura e tekstit Access 1 (Evans, Dooley, 2013) është bazuar në Gramatikë - Fjalor; Lexim - Dëgjim; Të folurit - Funksionet; Të shkruarit; Kulturë - Kurrikul



Teksti “Access 1” është i ndarë në 10 module me nga 6 tema. Çdo temë përbëhet nga fragmente të shkurtra të shoqëruara me pyetje rreth tekstit dhe me ushtrime gramatikore. Çdo modul prezanton një pjesë të rëndësishme të gramatikës. Nuk ka shumë informacion gramatikor sipas temave. E gjithë njohuria gramatikore ndodhet në seksionin “Grammar reference section” (Evans, Dooley.121-129). Dy kapitujt e fundit në çdo modul janë: *Këndi i kulturës* dhe *Curricular Cut*. Struktura e tekstit është bazuar në Gramatikë - Fjalor; Lexim - Dëgjim; Të folurit - Funksionet; Të shkruarit; Kulturë - Kurrikul. Në fund të çdo moduli ka një test vetëvlerësues, i cili mat njohuritë e përvetësuar nga nxënësi. Në fund të çdo moduli ka *Self-Check*, ku nxënësi mat dhe teston njohuritë e tij gramatikore dhe kuptimore. Nëpërmjet këtij teksti mësohen pothuajse të gjitha kohët e foljeve (Present & Past Simple, Present & Past Continuous, Present Perfect); shkallët e mbiemrave. Çdo modul jepet në linjë lineare dhe të përmbledhura në fund të librit në seksionin “Grammar reference section”. Teksti shoqërohet edhe me një tabelë foljesh të parregullta në fund të librit. Kërkesat më të hasura në këtë tekst janë: Look & Say; Listen & Repeat; Read & Match; Listen & Match, Look & Write etj. Vihet re se pjesa dëgjimore dhe ajo praktike janë më dominueset në veprimtaritë e nxënësit. Teksti është i shoqëruar gjithashtu me një fjalor të renditur sipas moduleve, ku paraqiten të grupuara foljet dhe mbiemrat.

LINJA TË PËRBASHKËTA TË MËSIMIT TË GJUHËS SË PARË DHE TË DYTË



Ndryshime strukturore të teksteve të Gjuhës Shqipe dhe Angleze

- Tekstet shqiptare i paraqesin njohuritë gramatikore në mënyrë lineare dhe koncentrike si dhe i integrojnë edhe komponentët gjuhësorë: *lexim, të folur dhe të shkruar*.

- Në tekstet angleze, njohuritë gjuhësore jepen përmes shembujve dhe dialogjeve, por pa dhënë rregulla gjuhësore
- Në tekstet angleze, ka një hapësirë ku nxënësit vlerësojnë punën e tyre, ndërkohë që në tekstet shqiptare nuk ekziston një formë e tillë.
- Tekstet e gjuhës angleze lidhin leximin me dëgjimin, ndërsa në tekstet e gjuhës shqipe leximi nuk lidhet me të dëgjuarin. Në tekstet e gjuhës angleze ka faqe kulturore, ku kultura gjuhësore bazohet në rregullat drejtshkrimore, në zhvillimin e gjuhës etj.
- Në tekstet e gjuhës angleze vlerësohet puna me projekte, ndërsa në tekstet gjuhës shqipe vihet re më pak.
- Në tekstet e gjuhës angleze ka një seksion të vecantë për gramatikën dhe një listë fjalësh për çdo modul, ndërsa në tekstet shqiptare nuk ka pasi gramatika paraqitet në pjesën e dytë të mësimi.
- Fjalori në tekstet shqiptare ndodhet në fund të çdo teksti leximi dhe jo në fund të cdo teksti.

Ndryshime përmbajtësore të teksteve të Gjuhës Shqipe & Angleze

- Tekstet shqiptare kanë fragmente më të gjata leximi, ndërsa ato të gjuhës angleze janë më të shkurtra.
- Tekstet shqiptare e paraqesin rubrikën “*Të shkruajmë*” dhe “*Të flasim*” në orë të veçanta mësimore, por që kanë lidhje me fragmentet e leximit, ndërsa tekstet angleze kanë ushtrime lidhur me të folurin dhe të shkruarin përgjatë leximit të fragmenteve.
- Në tekstet e gjuhës shqipe, njohuritë gramatikore paraqiten në mënyrë lineare dhe nuk ripërsëriten më në mësimet në vijim, si tek tekstet e gjuhës angleze.
- Në tekstet e gjuhës angleze ka të përfshirë shumë lojë me role, ndërsa në tekstet e gjuhës shqipe janë të përfshira në rubrikat e ndryshme.
- Në tekstet e gjuhës angleze çdo modul ka një mësim me dialogje, ndërsa në tekstet shqiptare dialogjet janë të paraqitura vetëm në rubrikën e leximit, por nuk ka dialogje për të mësuar gramatikën apo fjalë të reja përmes tyre.
- Në tekstet e gjuhës shqipe në fillim paraqiten njohuritë për emrin- mbiemri e më pas folja, kurse në ato angleze paraqiten në fillim foljet-kohët e foljeve-emrat, më pas mbiemrat.
- Larmia e teksteve të gjuhës angleze (lojërat, lojërat me role, këngët dhe projektet) i aftëson nxënësit në modele të ndryshme, ndërsa në ato shqiptare kjo mungon.
- Tekstet e gjuhës angleze kanë pantomima, ndërsa ato shqiptare jo. Tekstet e gjuhës angleze kanë përparësi, në lidhje me përmbledhjen gramatikore dhe fjalorin në fund të librit.

PËRFUNDIME

Mësimi i gjuhës së parë dhe të dytë në shkollat shqiptare në klasat II-V, mbështetet në parime përgjithësisht të njëjta për nga lineariteti dhe kronologjia e njohurive gramatikore të integruara me *të dëgjuarin*, *të lexuarin*, *të shkruarin* dhe *të folurin*. Qasja strukturore dhe përmbajtësore në krahasimin e këtyre teksteve mbështetur në tematika, linja, nënlinja, njohuri gjuhësore synoi në evidentimin e pikave të përbashkëta, por edhe në risitë që përcjellin secili prej këtyre teksteve.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (1954) *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- [2] Evans, V.; Dooley J., (2013) *Access 1*. Student’s book, Express Publishing, Newbury.
- [3] Evans, V.; Dooley J., (2013) *Access Workbook 1*, Express Publishing. Newbury.
- [4] Gray, E.; Evans, V., (2008) *Welcome 1*, Express publishing, EU.
- [5] Gray, E.; Evans, V., (2008) *Welcome 2*, Express publishing, EU.
- [6] Gjokutaj, M., Hoti, I.; Kadriu, D., (2016) *Fjalor termash në edukim*. Shtëpia Botuese “Dukagjini”, Prishtinë.
- [7] Hoti, I. (2013) *Gjuhësia e zbatuar përmes kurrikulës së gjuhës shqipe*. Shtëpia Botuese “Progresi”, Shkodër.
- [8] Osmani, Sh., (1983) *Fjalor i pedagogjisë*, Tiranë.
- [9] Petro, R.; Gjokutaj, M., (2003) *Gjuha shqipe 2*, Botimet shkollore Albas, Tiranë.
- [10] Petro, R.; Pepivani, N., (2003) *Gjuha shqipe 3*, Botimet shkollore Albas, Tiranë.
- [11] Petro, R.; Pepivani, N., (2003) *Gjuha shqipe 4*, Botimet shkollore Albas, Tiranë.

[12]Petro, R; Pepivani, N., Çerpja, A. (2013) *Gjuha shqipe 5*, Botimet Albas, Tiranë.